



2060/5  
29.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Nr. 304 prot.

Elbasan, më 29 .10.2020

VENDIM

Nr. 14 datë 29 . 10. 2020

PËR

**"MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROCESIT MËSIMOR NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË EDUKIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit të Elbasanit, Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 229, datë 04.05.2020 "Për miratimin e Udhëzuesit për masat ndaj Covid 19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore", Rregullores mbi masat sanitare për minimizimin e riskut nga Covid 19 në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", duke marrë parasysh propozimet e departamenteve të FSHE-së si dhe në zbatim të vendimit të Rektorit Nr. 01, datë 26.10.2020, numrit e studentëve, kapaciteteve mjedisore, respektimit të masave higjeno-sanitare mbi parandalimin e përhapjes së Covid 19, Dekanati i FSHE-së,

VENDOSI

1. Procesi mësimor në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, për vitin akademik 2020-2021 të zhvillohet i kombinuar në auditor dhe online në platformën Microsoft TEAMS, MOODLE.
2. Leksionet të zhvillohen online dhe seminarët në auditor në këto programe studimi:
  - a. Viti i tretë Bachelor në Punonjës Social;
  - b. Viti i parë dhe i dytë në Programin profesional 2 vjeçar "Edukator për fëmijët 0-3 vjeç";
  - c. Viti i parë, i dytë, i tretë Bachelor në Edukim Fzik dhe Sporte.
3. Të gjithë programet e tjera të zhvillojnë mësimin në auditor sipas orarit të përcaktuar.
4. Ngarkohet personeli akademik në zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof.as.dr. Elisabeta OSMANA

